

LUXODE STUDIO Sh.a.

Auto , Lubes, Technology

Rr.'Bardhok Biba ' P.Hodaj , Sh.A , Nr. 10 -1001 Tirane

Proces verbal
i Mbledhjes se Asamblese

I mbajtur sot me date 22.11.2021, ora 11000 ne seline e kompanise Luxode Studio Sh.a.me adrese: Rruga Bardhok Biba, Pallati Hodaj, Sh A nr 10, ne prani te aksionerit te vetem te Luxode Studio sha, z.Drilon Zajmi dhe administratorit z.Argus Xoxi me rend dite:

Shnderrimiin e formes ligjore te Luxode Studio nga “Shoqeri aksionare” ne “Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar”

Ne fillim e merr fjalën administratori z.Argus Xoxi i cili propozon shnderrimin e LUXODE STUDIO nga forma ligjore ‘sh.a’ ne formen ligjore ‘shpk’ duke parashtruar arsyet perkatese:

Argus Xoxi: Sic e kemi diskutuar , formen ligjore ‘shoqeri aksionare ’ per LUXODE STUDIO e propozuam ne kuadrin e negociatave dyvjecare me shoqerine **EVERGAIN AG**, me adrese: c/o Schel Part AG Baarerstrasse 53/55, Eichstätte, Postfach4559, CH-6304 Zug.

Objekti i negociatave ishte lidhja e kontrates se bashkepunimit te **EVERGAIN AG** me Luxode Studio, e cila nuk u be e mundur te lidhet brenda afatit dhe u shty per nje date te pacaktuar.




Nderkohe , forma ligjore ‘sh.a.’ nuk na siguron ndonje avantazh ne treg, as interesin e aksionereve te mundshem per investime. Perverc kesaj shpenzimet administrative ne formen ‘sh.a.’ rriten rreth tre here

Per kete arsye mendoj qe shoqerine ta kthejme ne formen ligjore “shpk”

Drilon Zajmi: Po, jam ne djeni per kete informacionin. Jam ne dijeni edhe per rritjen e shpenzimeve administrative dhe fiskale. Te autorizoj te kryesh ne emer te asamblese veprimet ligjore per kthim ne forme ligjore “shpk”.




Drilon Zajmi

Aksioner i Vetem

Argus Xoxi

Administrator

LUXODE STUDIO sh.a
Auto , Lubes , Technology , Services
Rr. Bardhok Biba, P. "Hodaj" Sh. A , Nr.10 Tirane ,

RAPORTI I ADMINISTRATORIT

PER SHNDERRIMIN E SHOQERISE « LUXODE STUDIO » NGA SHOQERI AKSIONARE NE SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Shnderrimi i LUXODE STUDIO sha ne formen juridike 'shoqeri me pergjegjesi te kufizuar '

RAPORT I ADMINISTRATORIT PER SHNDERRIMIN E SHOQERISE "LUXODE STUDIO" NGA SHOQERI AKSIONARE NE SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Ne zbatim te nenit 228 pika 1 germa "a", te nenit 229 pikat 1,2,5,6,7 e 8 te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtare e Shoqerite Tregtare", te Statutit shoqeria "LUXODE STUDIO"Sh.a. harton kete Raport te hollesishern te administrimit te shoqerise per proceduren e riorganizimit duke ndryshuar fornën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga shoqeri e formes shoqeri aksionare ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar si me poshte:

1-BAZA LIGJORE

Shoqeria "LUXODE STUDIO"Sh.a.,person juridik i se drejtes shqiptare, i regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, me seli ne Tirane adresa e numer NIPT-i L61415029I , me kapital te regjistruar ne vlere 3.663.160 leke dhe perfaqesohet nga administratori i saj z. Argus Xoxi.

Riorganizimi i shoqerise per ndryshimin te formes se vet ligjore nepermjet shnderrimit behet ne bazen ligjore dhe ekonomike si me poshte:

1. Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtare e Shoqerite Tregtare" Neni 228 pika 1 genna "a" dhe nenit 229.
2. Ligji Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
3. Ligji nr. 25/2018 date 10.05.2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
4. Statuti i shoqerise "The Plaza Tirana" sh.a.
5. Ne Pasqyrat financiare te vitit 2020 ku jane percaktuar dhe treguesit ekonomiko financiare te shoqerise.

2-MOTIVET DHE QELLIMI I SHNDERRIMIT

Arsyet që çojnë ne nje operacion te tille riorganizimi, të shndërrimit te shoqerise nga SHA ne SH.P.K. është se nga koha e krijimit te shoqerise dhe deri ne momentin që shoqeria shndërrohet në formen SHA., nuk ka patur nje zgjerim të shoqërisë ne tregje te reja, ne investime në

novacion te fushen e sherbimit etj. Edhe forma e administrimit si shoqeri aksionare nuk i ka krijuar mundësinë shoqerise per të krijuar interes tek të investitorët, edhe kostoja e parasë ne formen e sha është vieresuar me e lartë.

Shndërrimi i shoqërisë tregtare nuk sjell pasoja rmbi të drejtat dhe detyrimet që shoqeria ka marrë përsipër ndaj te tretëve.

Me kete operacion shoqeria “LUXODE STUDIO” sh.a., nga procesi i shnderrimit do te kete mundesi me te shpejte vendimmarrje, pasi dhe objekti i veprimtarise se shoqerise e kerkon nje shpejtesi te tille.

Sistemi ligjor, ekonomia dhe tregu i Shqiperise, nuk kane krijuar lehtesira per shoqerite e formes shoqeri aksionare ne krahasim me format e tjera te shoqerive. Gjithashtu shoqerite e formes aksionare jane përballur me fort me presionet e konkurrencës globale.

3-AKTIVET dhe PASIVET

Ndryshimet ne treguesit financiare nuk kane pasuar ndryshime te ndjeshme pasi aktiviteti i “LUXODE STUDIO” sh.a. ka zgjatur vetem kater muaj

4-MODALITETET

Shoqeria “LUXODE STUDIO”sh.a e cila do te shnderrohet ne nje forme te re si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne daten e realizimit perfundimtar te riorganizimit (shnderrimit) gezon frutet e shnderrimit duke filluar nga data e miratimit te riorganizimit te shnderrimit te shoqerise nga asambleja e aksionereve te shoqerise.

Kapitali i Shoqerise “LUXODE STUDIO” sh.a qe do te shnderrohet ne nje forme te re, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar “LUXODE STUDIO”sh.p.k. dhe nuk do te kete ndryshim ne zoterimin e kapitalit te shoqerise.

Ne vazhdim shoqeria do te vazhdoje te njejtin objekt veprimtarie, si dhe te njejten seli. Per shkak te ndryshimit te formes ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga shoqeri e forms shoqeri aksionare ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, aksioneret shprehen per miratimin e shfuqizimit te dokumentave ligjore te krijimit te shoqerise, pra Statuti, si dhe miratimin e dokumentacionit përkatës sipas ligjit per regjistrimin e shoqërisë ne formën e re ligjore, pra te Statutit te ri te Shoqense si Statut i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuara “LUXODE STUDIO” Sh.p.k.

Titulli i Statutit te Shoqerise ndryshon dhe behet nga “Statut i Shoqerise Aksionare “LUXODE STUDIO”sh.a., ne Statut i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “LUXODE STUDIO”

Sh.p.k.

Raporti i kembimit eshte miratuar nga aksioneret duke mos patur ndryshime, pra do te jene te njejtat raporte kembimi te aksioneve sipas perqindjeve ne pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerise me te njejte % te zoterimit te kapitalit nga ortaket ne pjese (kuota).

5-RAPORTET E KEMBIMIT

Kapitali i Shoqerise “LUXODE STUDIO” sh.a qe do te shnderrohet ne nje forme te re, ne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar “LUXODE STUDIO”sh.p.k. nuk do te kete ndryshim ne zoterimin e kapitalit te shoqerise ne perqindje, pra kapitali i shoqerise do te zoterohet

nga te njejtet ortake me te njejtat perqindje.

I vetmi ndryshim ne kete operacion riorganizimi eshte se zoteruesit e kapitalit do te quhen ortake dhe jo aksionere, si dhe kapitali i shoqerise nuk do te perbehet nga aksione, por nga pjese(kuota).

Raporti i kembimit eshte miratuar nga aksioneret duke mos patur ndryshirne, pra do te jene te njejtat raporte kembimi te aksioneve sipas perqindjeve ne pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerise me te njejtat % te zoterimit te kapitalit nga ortaket te ndare ne pjese (kuota).

Kapitali prej 3.663.160,000 lek i Shoqerise "LUXODE STUDIO" sh.a., mbas riorganizimit nepermjet shnderrimit ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar "LUXODER STUDIO" sh.p.k. do te zoterohet nga ortaket:

-Drilon Zajmi , zoteron 100% te kapitalit, ne viere prej 3.663.160,000 leke I perbere nga nje pjese, 6-TE DREJTA DHE AVANTAZHE TE TJERA

Ky operacion riorganizimi nepermjet shnderrimit ne nje forme te re, ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar "LUXODE STUDIO" sh.p.k. nuk do te permbaje, te drejta dhe vantazhe te vecanta pas perfundimit te operacionit te riorganizimit(shnderrimit).

7-VESHTIRESITE E VECANTA TE SHNDERRIMIT

Operacioni i riorganizimi nepermjet shnderrimit ne nje forme te rc, ne shoqeri mepergjegjesi te kufizuar "LUXODE STUDIO"sh.p.k, vieresimi per aktivet dhe pasivet,

Percaktimi i kapitalit nuk ka vcshtiresi te vecanta, nisur nga sa cituam me siper pasi zoterimi i kapitalit eshte nga te njejtet aksionere/ortake, dhe per kete shkak eshte propozuar dhe Perjashtimi i Eksperteve te fushave te ndryslime, si e drejte qe i lind referuar Ligjit nr. 9901, date I 4.04.2008"Per Tregtare e Shoqerite Tregtare".

8-EFEKTET E SHNDERRIMIT MBI KREDITORET, TE TRETET DHE PUNONJESIT E SHOQERISE.

• Klientet, Debitorët, Kontratat, do te respektohen ne te gjithë te drejtat dhe detyrimet ne kontratat e lidhura midis shoqerise" LUXODE STUDIO "sh.a., duke u konsideruar qe jane lidhur nga shoqeria e shnderruar ne formen e re me pergjegjesi te kufizuar "LUXODE STUDIO" sh.p.k.

• Te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Debitorëve te shoqerise se shnderruar Shoqeria "LUXODE STUDIO"Sh.a. do ti respektoje Shoqeria e formes se re "LUXODE STUDIO" sh.p.k., ne vazhdimesi.

• Kreditoret, Furnitoret, Bankat, do te gezojne te gjithë te drejtat qe kane tek Shoqeria e shnderruar, pas ketij riorganizimi te gjithë te drejtat e kreditorëve(Ortake, Furnitoret, Bankat) do te permbushen nga shoqeria e formes se re "LUXODE STUDIO" sh.p.k.

• Organet Tatimore, do te gezojne te gjitha te drejtat qe kane tek Shoqeria e shnderruar, pas ketij riorganizimi te gjitha te drejtat e tyre do te permbushen nga Shoqeria e formes se re "LUXODE STUDIO" sh.p.k.

• Pas riorganizimit nepermjet shnderrimit punonjesit aktuale do te gezojne te gjitha te drejtat qe kane tek Shoqeria e shnderruar, pra e gjitha te drejtat e punonjesve do te permbushen nga Shoqeria e formes se re "LUXODE STUDIO" sh.p.k.

9-TE DHENAT E SHOQERISE SE SHENDERRUAR PAS RIORGANIZIMIT

Pas perfundimit te operacionit te riorganizimit nepermjet shnderrimit ne nje forme te re, nga shoqeri aksionare ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar "LUXODE STUDIO" sh.p.k. do te jene:

- Selia; Tirane,
- Administratori: Z.Argus Xoxi .
- Emertimi i shoqerise do t e jete "LUXODE STUDIO" sh.p.k.
- Kapitali i shoqerise "LUXODE STUDIO" sh.p.k do te jete 3.663.160 (leke) dhe do te zoterohet nga ortaku: Drilon Zajmi
- Objekti i Aktivitetit: Tregti me shumice i nenprodukteve te hidrokarbure. Sherbime: urbanistike dhe arkitektonike te llojeve te ndryshme, Tregti: Import-tregtim automjete, pjese nderrimi, autogoma, bateri, lubrifikante, makineri, pajisje elektrike, mekanike, mjeksore, 2 industriale, gjeneratore, transformatore, bujqesore, automotive. Per transmetimin, kontrollin, matjen e energjise. Lende djegese. Sisteme sigurie. Materiale pajisje hotelerie dhe mobilimi. Tregtim mallra ushqimore. Lubrifikante, pjese kembimi, autogoma, lavazh. Materiale, pajisje elektrike dhe elektronike. Materiale, pajisje didaktike, pajisje laboratorike dhe sherbime per to. Sherbime: Servis automjetesh, makineri pajisje, mekanike, elektrike etj. Lavazh automjetesh. Pastrim mbeturinash urbane dhe spitalore. Transport mallrash kombetar dhe nderkombetar. Agjenci udhetimesh kombetare dhe nderkombetare. Sherbime perkthimi. Trajnime. Sherbime avokatie. Instalim, konfigurim, pajisje elektronike software dhe hardware.

10- Ligji i zbatueshem i Riorganizimit te Shoqerive eshte ligji Shqiptar. Cdo mosmarreveshje apo konflikt ne lidhje me operacionin e riorganizimit nepermjet shnderrimit do te zgjidhet perfundimisht nga Gjykatat kompetente Shqiptare.

11- Riorganizimi i shoqerise nepermjet shnderrimit hyn ne fiaqi ditën ne te cilen miratohet nga asambleja e aksionereve te shoqerise sipas afateve te miratuara nga asambleja.

Tirane, me 22.11.2021

Per "LUXODE STUDIO" sh.a.

ADMINISTRATORI

Z. Argus Xoxi



LUXODE STUDIO sha
Auto , Lubes, Technology
Rr.'Bardhok Biba ' P.Hodaj , Sh.A , Nr. 10 Tirane

Nr. 25/d Prot

Vendim i Asamblese se Aksionereve

Sot, me date 25.11.2021 ne seline e **LUXODE STUDIO** , adresa Rr.'Bardhok Biba ' P.Hodaj , Sh.A , Nr. 10 -1001 Tirane u mbajt mbledhja e asamblese se aksionereve te LUXODE STUDIO Sha, me rend dite:

-Miratimin e “Vendimit per shnderrimin e shoqerise aksionere ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar”.

Ne mbledhje moren pjese aksioneret: Z.Drilon Zajmi i biri i Albertit, shtetas Kosovar , lindur me 17.12.1990, ne Gjakove, mbajtes i pasaportes ne Nr P00815191, banues ne Tirane , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, zoterues i 100 % te aksioneve te shoqerise LUXODE STUDIO sh.a. –

Ne mbledhje mori pjese edhe administratori i shoqerise z. Argus Xoxi , pa te drejte vote. Asambleja e aksionereve te Shoqerise LUXODE STUDIO sh.a. mori ne shqyrtim rendin e dites si me poshte

- Shqyrtimi i ndryshirnit te formës ligjore, nepernjete shndërrimit nga shoqeri e formes shoqeri aksionare ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.
- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit te administrimit ku do te shpjegohen ne menyre të hollësishme, bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit të propozuara. Ne raport do te përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta qe jane jane hasur ne vlerësim.
- Shfuqizimin e Statutit te Shoqerise si Statut i nje shoqeri aksionare dhe miratimi i Statutit te ri te Shoqerise si Statut i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “
- Konfirmimin ne detyre te administratorit Z. Argus Xoxi.
- Shkrirja e organit ” Keshilli Mbikqyres” qe nuk kerkohej ligjerisht per formen “shpk”

Asambleja e Jashtezakonshme e Shoqerise “LUXODE STUDIO”Sh.a. pasi mori ne shqyrtim rendin e dites te caktuar nga Keshilli i Administrimit te shoqerise, ne perputhje me kerkesat e pikes 21.1 te nenit 21 te Statutit per diskutimin e propozimit te Keshillit te Administrimit te Shoqerise“LUXODE STUDIO”Sh.a. aksioneret u shprehen per miratimin e ndryshimit te formës ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga shoqeri e formes shoqeri aksionare ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas raportit te administrimit ku jane shpjeguar ne menyre të hollësishme, bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit tëpropozuar.



Ne raport gjithashtu jane pershkruar edhe veshtiresite e vecanta te vleresimit, te cilat jane hasur. Per shkak te ndryshimit te formes ligjore, nepermjet shnderrimit nga shoqeri e formes shoqeri aksionare ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, aksioneret shprehen per miratimin e shfuqizimit te Statutit te shoqenise si dhe miratimin e dokumentacionit perkates sipas ligjit per regjistrimin e shoqerise me formen e re ligjore, pra te Statutit te ri te Shoqerise si Statut i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "LUXODE STUDIO" shpk

Aksioneret u shprehen dhe per konfirmimin ne detyre te administratorit, me afat prej 5 vjet.

Ne perfundim aksioneret votuan per te gjitha pikat e rendit te dites dhe: pasi morem ne shqyrtim rendin e dites, ne mbeshtetje te Ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe Statusit te Shoqerise vendosen:

VENDOSEN

1- Miratimin e ndryshimit te fomës ligjore te shoqerise "LUXODE STUDIO" nepermjet shnderrimit nga shoqeri e formes shoqeri aksionare ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

2- Miratimi i Raportit te adminsitrimit ku shpjegohen ne menyre te hollësishme, bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit të propozuar, si dhe veshtiresite e vecanta te vleresimit te hasura

3- Kapitali i shoqerise nuk ndryshon as ne viere si dhe ne perqindjet e zoterimit nga ortakët, pra kapitali mbetet ne viere prej 3.663.160 leke dhe zoterohet ne masen 100% nga aksioneri i vetem z. Drilon Zajmi

4- Miratimin e ndryshimeve ne Statutin te Shoqerise duke shfuqizuar dokumentat ligjore te Statutit te meparshem si dhe duke miratuar Statutin te ri te Shoqerise si Statut i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "LUXODE STUDIO" Sh.p.k.

5- Miratimi konfirmimit ne detyre te administratorit te shoqerise z. Argus Xoxi me nje afat prej 5-vite (nga data e depozitimit prane QKB te vendimit den ne plotesimin e afatit prej 5- vite).

6- Shkrijta e organit " Keshilli Mbikqyres" qe nuk kerkohet ligjerisht per formen "shpk"

7- Autorizohet z.Argus Xoxi te kryeje aplikimin ne Qendren Kombetare te Biznesit sipas kerkesave te Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar", dhe statutit te shoqerise, per depozitimin e dokumentave qe kane te bejne me miratimin e pikave te rendit te dites ne kete mbledhje te asamblese.

Drilon Zajmi

Aksioner i vetem

Tirane 25.11.2021

